Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Lulzim Bajrami	**04.12.2023**	**04.12.2023**	**2023/0967**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 01.12.2023, OE "PATRONI SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0967, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"FURNIZIM ME LËNDË DJEGËSE PËR KALDAJË – MAZUT(Fuel Oil 1.0%)" me nr. të prokurimit: "KEK-23-6766-1-1-1",** iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a..Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, furnizim, vlera e parashikuar e kontrates 4,200,000.00 € + 499,056.45 shtesa = **4,699,056.45** €. Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apoNjoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 66 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Neni 70 i LPP-së
Neni 62 i LPP-së
Neni 72 i LPP-së
Neni 43 i Rregullores Nr.001/2023 për Prokurim Publik

*** Sipas Nenit 118të LPP, OSHP-ja do të kthejtarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenëte rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Njoftimi për Kontratë: 04.07.2023, kurse data e hapjes së ofertave është bërë me dt.19.07.2023.

Fillimisht ju sqarojmë se në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit, në vlerësimin e parë ishim rekomanduar për kontratë ne, ndërsa më pastaj ka pasur një ankesë në OSHP nga operatori ekonomik tjetër (Ex Fis) i cili është me çmim më të shtrenjtë se sa oferta jonë. Pas ankesës është nxjerr ekspertiza e ekspertit shqyrtues e dt.11.08.2023 më Nr. 2023/0563, ku është rekomanduar që të mbetet në fuqi njoftimi mbi vendimin, në të cilin ishim rekomanduar për kontratë. Vendimi i OSHP-së me Nr. 2023/0563 është nxjerr me dt.20.10.2023 ku lënda është kthyer në rivlerësim dhe ankesa e OE ankues ishte aprovuar pjesërisht si e bazuar.

Pas rivlerësimit është nxjerr njoftimi mbi vendimin e AK-së është bërë me dt. 15.11.2023 ku është anuluar ky aktivitet i prokurimit me arsyetimin se

Rezultati i aktivitetit te prokurimit:
Ofertat e pranuar janë te papërgjegjshme, rrjedhimisht e tejkalojnë vlerën e parashikuar nga Autoriteti Kontraktues për këtë aktivitet te prokurimit, andaj konform nenit 62 te LPP-se ky aktivitet i prokurimit anulohet.

Neve na është dërguar letra standarde për tenderues të eliminuar me arsyetimin si në vijim:

Eliminoheni nga ky aktivitet i prokurimit pasi qe ne ofertën tuaj keni prezantuar një dokument ne dëshinë e origjines se mallit nga OKTA mirëpo konform vendimit te OSHP-se nr 2023/0563 ju jemi drejtuar me pyetje sqaruese për te vërtetuar origjinën e mallit me datën 30.10.2023 dhe pas përgjigjes nga ju me datën 01.11.2023 keni ndryshuar dokumentin e prejardhjes duke e zëvendësuar me LOTUS OILTRADE LTD gjë qe është e pa pranueshme pasi qe konsiderohet dokument i cili nuk ka ekzistuar me rastin e hapjes se ofertave dhe konsiderohet si ndryshim i ofertës dhe si i tille e bene te pa përgjegjshme ofertën tuaj.

Sa i përket arsyes së anulimit të këtij aktiviteti të prokurimit nga ana e AK-së, ju sqarojmë se vlera e ofertëstonë me të cilën jemi shpall fitues në vlerësimin e parë ka qenë e njëjta vlerë sikurse tani, prandaj nuk është arsye e bazuar konstatimi dhe vendimi që të anulohet ky aktivitet i prokurimit për shkak të tejkalimit të vlerës së parashikuar.

Nëse ka pas mjete në muajin Gusht kur jemi shpall fitues atëherë edhe tani ka mjete të mjaftueshme për tu realizuar ky projekt. Po ashtu kjo arsye nuk është përmendur asnjëherë as gjatë fazës sa ka qenë në ankesë ky projekt, prandaj nuk duhet anuluar ky aktivitet i prokurimit sepse realisht nuk ka bazë dhe arsye ligjore e as faktike.

Gjithashtu duke pasur parasysh vlerën e çmimit të mazutit në treg, kuptohet qartë që vlera e parashikuar është nën vlerën e çmimit të tregut, prandaj nga ky fakt vijmë në përfundim se edhe nëse anulohet ky aktivitet i prokurimit nuk mund të realizohet me këtë vlerë të parashikuar por duhet të rritet vlera e parashikuar. Prandaj mund të ketë vetëm vonesa për tu përfunduar kjo kontratë dhe se çmimi i tregut është ky që është, ndërsa i vetmi ndryshim në këtë rast është se shkaktohen vonesa në përfundim të këtij projekti.

OSHP-ja ka nxjerr vendime dhe tashmë ekziston njëpraktikë e mirë e vendimmarrjes në lidhje me tejkalimin e vlerës së parashikuar, ku në vendimin Nr. 2023/0171 të dt.27.06.2023paneli shqyrtues kishte konstatuar se AK nuk kishte arritur ta bind panelin shqyrtues seka mungesë të mjeteve apo që ato nuk mund të rialokohen, duke theksuar mbi këtë bazë ligjore PSH konstaton se aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim.
Ky vendim ka të bëjë me aktivitetin e prokurimit "Ekzekutimi i punëve=Ndërtimi i fazës së katërt Beteja e Kosharës, Koshare-Gjakovë-Ritender me nr. prok:253-22-9179-5-1-1, iniciuar nga Agjencia për Menaxhimin e Kompleksëve Memoriale të Kosovës.
Për më tepër vetë përfaqësuesi i AK-së (KEK) në seancën dëgjimore e cila ishte mbajtur me dt.04.10.2023kishte konfirmuar se ne jemi rekomanduar për kontratë se ka pasur mjete, pavarësisht që është tejkaluar vlera e parashikuar.
Sa i përket arsyes së eliminimit, se ne kemi ndryshuar dokumentin e origjinës së mallit prej OKTA që është dorëzuar në ofertë, me dokumentin LOTUS OILTRADE LTD, ju sqarojmë se ne nuk kemi bërë asnjë ndryshim material të ofertës dhe të dëshmive që janë ofruar sipas kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Ne me dosje të tenderit nuk kemi ofruar asnjë deklaratë për origjinë të mallit, prandaj nuk ka asnjë ndryshim sa i përket kësaj dëshmie e cila kërkohet të ofrohet para se të bëhen furnizimet, pra pas nënshkrimit të kontratës.

Faktin se deklarata për origjinë të mallit nuk ka qenë kërkesë e FDT-së, e ka cekur edhe Paneli shqyrtues i OSHP-së, ku në vendimin e tyre të dt. **20.10.2023 me Nr. 2023/0563** e kanë cekur qartë se deklarata e prodhuesit për origjinën e mallit nuk ka qenë kërkesë kualifikuese por është kërkuar tek aneksi 1-specifikimet teknike të detyrueshme.
Më pastaj paneli shqyrtues ka vlerësuar se duhet të kthehet lënda në rivlerësim dhe të kërkohen sqarime sipas nenit 72 të LPP-së.

Gjatë rivlerësimit AK-ja ka kërkuar sqarime nga ne, me pyetjen që të deklarohemi për vendin e origjinës së mazutit dhe prodhuesin.
Pyetja ka qenë që të deklarohemi për vendin e origjinës së mazutit dhe prodhuesin, ndërsa ne jemi përgjigjur duke sqaruar se Origjina e Mazutit do të jetë nga Bullgaria nga prodhuesi LotusOil TRADE LTD.
Realisht pyetja sqaruese ka qenë e panevojshme për tu parashtruar sepse deklarata për vendin e origjinës së mazutit nuk ka qenë kërkesë e kualifikueshmërisë dhe kërkesë obligative në këtë fazë. Ky fakt vërehet më poshtë ku e kemi bashkangjitur specifikimin teknik me kërkesat e specifikuara, e ku shihet që deklarata në fjalë është kërkuar tek karakteristike teknike të mazutit.

Aneksi 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

Nr	Përshkrimi	Njësia	Sasia e përafërt për muaj
1	**Lëndë djegëse për Kaldajë –Mazut Fuel Oil 1.0%**	ton	7000

Realizimi do te behet ne baze te porosive te lëshuara nga Zyra e Ekzekutive e Prokurimit
Pranimi i sasive nga autoriteti kontraktues do te jete nga ora 8.00-14.00 gjate diteve te punes.
Fituesi potencial duhet të ketë kapacitete teknike për liferimin e 250 toneve për 5 ditë , në rastet emërgjen 500 ton
Certifikatat e kualitetit për çdo liferim duhet të jetë jo me e vjetër se 30 ditë (një muaj)
Obiligim kontraktual i Operatorit ekonomik eshte që për çdo liferim të sjell 4 epruveta për marrjen e mostra të mazutit. Epruvetat duhet të jenë të setrilizuara dhe me rastin e marrjes të mostrave do të bllombohe bllombat të jenë të OE dhe mostrat të bllombohen në prezencën e OE. Dhe 3 epruveta do te marre Autorit kontraktues ndersa nje do te jipet Operatorit ekonomik .

KARAKTERISTIKAT TEKNIKE TË MAZUTIT

	Njësija	Mazut i rëndë
Mazut i mesëm		
Vlera kalorike 9500	Kcak/kg	9500
Dendësija në 15 ^{0}C 0.95	Kg/dm^3	0.95
Viskoziteti në 100 ^{0}C 3.0/21	^{0}E/cst	7,0/53
Pika e ndezjes min. 80	^{0}C	min. 100
Lagështija dhe të dhënat e ngurta max.1.5	%	max.2.0
Hiri max. 0,20	%	max. 0.20
Sulfuri i gjithmbarshëm max.1	%	max 1
Treguesi Conradson max 15.0	%	max 10.0

OE përmes nje deklarate duhet te deklarohet lidhur me vendin e origjinës se Mazutit dhe Prodhuesin.

Kur kemi parasysh faktin se deklarata e origjinës së mazutit, nuk ka qenë kërkesë në FDT, pra nuk ka qenë kërkesë e kualifikueshmërisë, atëherë rezultonse ne jemi eliminuar për një kërkesë e cila nuk ka qenë kërkesë e FDT-së dhe e njoftimit për kontratë, prandaj në këtë rast është vepruar në kundërshtim me nenin 56.3 të LPP-së.
Certifikata e kualitetit e bashkangjitur nga ne e lëshuar nga OKTA është një dokument i cili është bashkangjitur me dosje, jo për të plotësuar ndonjë kërkesë të dosjes së tenderit, pasi që nuk ka pasur një kërkesë të tillë në FDT, por ky dokument është bashkangjitur si dokument / dëshmi se ne kemi realizuar kontratë me specifika siç kërkohet tek aneksi 1 i dosjes së tenderit.

Po ashtu certifikata e bashkangjitur e kualitetit nuk duhet ngatërruar me deklaratën e kërkuar tek specifikimet teknike.
Duke pasur parasysh që në FDT nuk ka pasur një kërkesë për deklaratë të origjinës së mazutit, ne nuk kemi bashkangjitur një deklaratë të tillë, sepse deklarata së bashku me certifikatën e kualitetit kërkohen pas nënshkrimit të kontratës.
Me rastin e sqarimeve shtesë ne e kemi bërë të ditur se origjina e mazutit do të jetë nga Bullgaria nga prodhuesi LotusOil Trade LTD, edhe pse nuk kemi qenë të obliguar në këtë fazë të japim këtë sqarim sepse nuk është kërkesë e FDT-së dhe e njoftimit për kontratë.

Në këtë rast nuk kemi asnjë dokument të ri, e as ndonjë ndryshim material në dokumentet e dosjes së tenderit, sepse ne me rastin e ofertimit nuk kemi dorëzuar asnjë deklaratë në lidhje me origjinën e mazutit, prandaj ofrimi i deklaratës me rastin e sqarimeve shtesë se nga e ka prejardhjen mazuti nuk bie në kundërshtim me asnjë dëshmi tonën që e kemi dorëzuar me dosje të tenderit.

Madje tek specifikimet teknike të detyrueshme në lidhje me certifikatën e kualitetit shkruan si në vijim, **citojmë**: "Çertifikatat e kualitetit për çdo liferim duhet të jetë jo me e vjetër se 30 ditë (një muaj) Obiligim kontraktual i Operatorit ekonomik është që për çdo liferim të sjell 4 epruveta për marrjen e mostrave të mazutit. Epruvetat duhet të jenë të sterilizuara dhe me rastin e marrjes të mostrave do të bllombohen, bllombat të jenë të OE dhe mostrat të bllombohen në prezencën e OE. Dhe 3 epruveta do te marre Autoriteti kontraktues ndërsa një do te jipet Operatorit ekonomik", **mbarim citati**.
Pra certifikata e tillë duhet të dorëzohet me rastin e furnizimeve, prandaj as në vlerësim e as gjatë rivlerësimit autoriteti kontraktues nuk ka pasur arsye ligjore të merret me këto dokumente të panevojshme dhe jo obligative në këtë fazë.
Me prodhuesin LotusOil Trade LTD nga Bullgaria ne e kemi realizuar kontratën paraprake prej 1000 ton dhe nuk kemi pasur asnjë problem, këtë fakt Autoriteti Kontraktues e ka ditur shumë mirë, prandaj kemi kërkuar që të merret parasysh kërkesa jonë për rishqyrtim si e bazuar.

Sa i përket autorizimit të ofruar nga EX FIS që e ka marr nga OKTA, ju sqarojmë se OKTA-së i është ndaluar prodhimi diku prej vitit 2011 dhe tani është vetëm distributor, prandaj nuk duhet të merren parasysh këto dëshmi që janë ofruar nga EX FIS e po ashtu nuk duhet të merren parasysh edhe nëse ofrohen nga kompani të tjera, qoftë edhe nga ne.
Ky operator ekonomik është i papërgjegjshëm për këtë arsye.
Për më tepër OKTA në autorizim e ka cekur se nuk merr **asnjë përgjegjësi për cilësinë** apo **sasinë e dorëzuar** nga ExFis SHPK. Ju lutem lexonedhe analizoni tekstin e mëposhtëm i cili gjendet në autorizim.

OKTA explicitly states that the aforementioned contract is not exclusive and OKTA does not provide the transport services to **Kosovo Energy Corporation J.S.C.** as such OKTA assumes no responsibility for the quality or quantity delivered by Ex Fis SH.P.K., Pristina, Kosovo to Kosovo Energy Corporation J.S.C.

Edhe po të ishte prodhues OKTA, me këtë autorizim ku nuk merr përgjegjësi për cilësi dhe sasi nuk mund të jetë i përgjegjshëm OE Ex Fis SHPK dhe nuk ka vlerë ky autorizim, prandaj autorizimi në fjalë është plotësisht i pavlefshëm.Hipotetikisht si mund të nënshkruhet një kontratë kur nuk merret përgjegjësia për cilësi dhe sasi?
Edhe nga autorizimi shihet që nuk është prodhues OKTA, prandaj ky autorizim është i pavlefshëm.

Po ashtu edhe licenca për import të vajrave e OE Ex Fis është me afat të skaduar, ku e njëjta licencë ka skaduar me dt. dt.18.10.2023 dhe nuk ka dëshmi se është vazhduar.

Se nuk është kërkuar deklarata për origjinë të mazutit në FDT, shihet edhe nga oferta e OE EXFIS, ku edhe ky OE nuk e ka ofruar deklaratën në fjalë.

Ne me dt.22.11.2023 kemi pranuar vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, ku autoriteti kontraktues e ka cekur se e njëjta është e pa bazuar, mirëpo që vendimin e saj nuk e ka arsyetuar fare.
Edhe në përgjigje është cekur se është kërkuar deklaratë për origjinën e mazutit dhe prodhuesin dhe atë në faqen 16 tek specifikimet teknike. Pra edhe nga vetë autoriteti kontraktues është cekur se kjo deklaratë nuk është kërkuar në FDT, prandaj normalisht që nuk mund të eliminohemi për një kërkesë e cila nuk është kërkuar në FDT.
Në përgjigje vetëmështë përsëritur arsyeja e anulimit dhe e eliminimit të kompanisë tonë.
Në lidhje me OE Ex Fis edhe vetë OE në mënyrëimplicite e ka pranuar se as ky OE nuk ka ofruar deklaratë për prejardhjen dhe vendine origjinës, mirëpo mundësohet të ,mbulojë me autorizimin nga OKTA.
Sa i përket pretendimit tonë se OKTA-së i është ndaluar prodhimi diku nga viti 2011, autoriteti kontraktues vetëm e ka cekur se këtë çështje në të kaluarën e kemi vërtetuar këtë çështje dhe për këtë nuk kanë dyshime. Pra autoriteti kontraktues nuk ka mundur të dëshmojë dhe të argumentojë se OKTA-së nuk i është ndaluar prodhimi, prandaj ky OE është i papërgjegjshëm.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

Duke pasur parasysh këto fakte rezulton se anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit është bërë në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së dhe në kundërshtim me nenin 43.7 të rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, ku Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.
Po ashtu nuk është marr në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.
Gjithashtu nuk është respektuar edhe neni 6 i LPP-së, edhe pse Autoriteti Kontraktues është

obliguar që të sigurojë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, kur dihet që në këtë aktivitet të prokurimit ne jemi OE i përgjegjshëm dhe me çmim më të lirë.
Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet të cilat u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP që të nxjerr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE **NPATRONI SH.P.K ".**
ANULOHET,njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe lënda të kthehet **RIVLERËSIM,**
DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

KRITERET PËR VLERËSIM

Dosja e tenderit dhe LPP

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

Me daten 01.12.2023 konform LPP Nenit 114 kam këkruar nga AK sqarim lidhur me konfirmimin e mjeteve financiare lidhur me aktivitetin ne fjalë

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

O.E. është palë e interesit

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

Vendimi i PSH.OSHP nr.0563 lidhur me ankesen e OE. EX FIS ndaj kesaj prodecure

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **PATRONI SH.P.K.**

Eksperti shqyrtues pas ekzaminimit te dosjes se tenderit, shqyrtimit te rrjedhës se procedurës se tenderimit si dhe shqyrtimit te pretendimeve ankimore lidhur me anulimin e procedurs dhe dokumentit mbi prejardhjen dhe prodhuesin e mazutit sqaron si vijon:

Përgjegjie e ekspertit ne pretendimin ankimore nr.1: Lidhur me anulimin e aktivitetit te prokurimit ne munges te mjeteve buxhetore:

Vlera e planifikuar e aktivitetit te prokurimit ne dosjen e tenderit dhe DNPDF te publikuar ne e-prokurim me date 04.07.2023 ka qenë 4,200,000.00 € + 499,056.45 shtesa = 4,699,056.45 €

***II.1.3* Vlera e parashikuar :**

Vitet	*Vlera për vit*	*Vlera totale*	***Kodi i Buxhetit***
2023	***1,050,000.00***	*4,200,000.00*	GE-23-B-O-1
2024	***2,100,000.00***		GE-24-B-O-1
2025	***1,050,000.00***		GE-25-B-O-1

Shënim: Nëse është kontratë kornizë buxheti duhet të jetë për të tri vitet sa zgjat kontrata!

***II.1.4* Kushtet Materiale:**

Furnizim me lëndë diegëse – mazut (Furnizim dy vjeqar + - 30%)

***II.1.5* Specifikacionet funksionale, përfitimet dhe kostot:**
Referoju Aneksit I të bashkangjitur.

***II.1.6* Planifikimi:**
A ka qenë ky aktivitet i prokurimit i përfshirë në parashikimin e prokurimit? Po [x] Jo [ ]

951 - 30.06.23

Nëse jo, deklaro arsyen pse nuk ka qenë i përfshirë
larata]

***II.1.7* Deklarata lidhur me atë se si ky prokurim do të promovojë objektivat institucionale të autoriteteve kontraktuese:**
rata]

tamenti kërkues:	*Termocentrali "Kosova B*
i kërkues:	***Nexhat Llumnica***
ıkrimi i personit kërkues,	20.06.2023
ri i Divizionit	***Jonuz Saraçi***
ıkrimi i Drejtorit,	20.06.2023

Duke pasur parasysh se kjo procedurë ka pasur edhe vendim te PSH.OSHP me **nr.2023/0563** me te cilin është kërkuar që procedura te kthehet ne rivleresim, AK gjatë fazës se rivleresimit ka bërë anulimin e aktivitetit te prokurimit duke u mbështetur ne Nenin 62 pragrafi 2 pika 21.1 te LPP si munges e mjeteve buxhetore për këtë aktivitet:

Si rezultat i kësaj OE „PATRONI SHPK" ka paraqitur ankesen ndaj anulimit te procedures se prokurimit.

Duke pasur parasysh këtë ne bazë te LPP Neni 114 me daten 01.12.2023 ju kam drejtuar AK me shkrim qe te me njoftoj me me shkrim lidhur me konfirmimin e mjeteve buxhetore, me daten 04.12.2023 AK - KEK ne baze te kërkesës me ka kthyer përgjegjien sqaruese lidhur me këtë, ku ka potencuar se vlera e aktivitetit te inicuar ka qenë ***4,200,000.00 euro ku pas analizimit dhe vlerësimit financiar me vendim te bordit janë alokuar mjetet shtese prej 499,058.45 euro, dhe vlera totale e projektit pas shtimit te mjeteve buxhetore arrin në 4,699,058.45 euro.***

Shih kërkesen e ekspertit dejtuar AK-së, KEK-ut:

Gmail

lulzim bajrami <lulzimmbajrami@gmail.com

Kërkes për sqarime shtesë konform LPP ne cilesin e ekspertit shqyrtues sipas autorizimit te OSHP

1 message

lulzim bajrami <lulzimmbajrami@gmail.com> Fri, Dec 1, 2023 at 2:39 P
To: ymer.dragusha@kek-energy.com

I nderuar,

Ne bazë te Autorizimit te PSH.OSHP ne cilësin e ekspertit shqyrtues lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore te ngritura nga operatori ekonomik **,,EX-FIS "** lidhur me proceduren e prokurimit me titullin **,,FURNIZIM ME LËNDË DJEGËSE PËR KALDAJË - MAZUT(Fuel Oil 1.0%)''** te bëra ndaj anulimit te aktivitetit te prokurimit si rezultat i tejkalimit te ofertave me buxhetin e planifikuara.

Ju lutemi kam nevoj për disa sqarime shtesë me qëllim te vërtetimit dhe konstatimit te pretendimeve te ngritura karrshi anulimit te procedures.

Procedura e prokurimit fillimitshtë ka rezultuar me dhënie te kontrates për operatorin ekonomik **Patroni shpk,** ku me qërast si rezultat i ankesave te paraqitura ne OSHP procedura konform vendimit te PSH. OSHP është kthyer ne Rivleresim, ku me pas është bër anulimi me arsyetimin se jane tejkaluar ofertat me buxhetin e planifikuar.

Ju lutemi a keni konfirmim final nga ZKF lidhur me këtë se nuk ka mjete te mjaftueshme buxhetore për mbulimin e këtyre ofertave nëse keni ju lutemi qe te ma dërgoni mundesisht deri diten e Hëne DT.04.12.2023

Me respekt

Lulzim Bajrami

Shih njoftimin sqarues derguar nga AK-KEK:

Driton Bytyqi <Driton.Bytyqi@kek-energy.com> Mon, Dec 4, 2023 at 4:08 PM
To: Iulzim bajrami <Iulzimmbajrami@gmail.com>

I nderuar,

Disponueshmëria e mjeteve për këtë aktivitet te prokurimit është aprovuar nga dhe ZKF dhe ZKA 4,200,000 euro, siç shihet edhe ne DNPDF e ngarkuar ne platforme.

Fillimisht Autoriteti Kontraktues ka propozuar për dhënie me kontrate OE "PATRONI SHPK", i cili ka ofruar premiumin për një (1) ton lende djegëse mazut 112.20 EURO, ku pas analizimit dhe vlerësimit financiar me vendim te bordit janë alokuar mjetet shtese prej 499,058.45 euro. Pas ankesës se OE "EX-FIS SHPK" ashtu siç keni cekur edhe ju lënda është ktheyer ne ri-vlerësim.

Autoriteti Kontraktues ne baze te vendimit te OSHP-se ka analizuar, vlerësuar, krahasuar dhe sqaruar ofertat ne detaje, ku si përfundim OE "PATRONI SHPK" është eliminuar për shkak te disa vërejtjeve te cilat i gjeni ne raportin e

vlerësimit dhe dokumentet tjera ne platforme. Autoriteti Kontraktues ka analizuar ofertën financiare te OE EX-FIS SHPK dhe ka ardhur ne përfundim se ky OE ka ofruar Premium shume te larte prej 156.67 euro për një ton lende djegëse-mazut, qe ne përqindje I bie 39.63% premiumin me te lart se OE "PATRONI SHPK".

Për vëmendjen tuaj, kontrata kornize e cila ka qene ne fuqi pikërisht me OE "EX-FIS SHPK" ka qene e kontraktuar me çmimin e premiumit prej 116.20 euro për një tone lende djegëse-mazut.

Autoriteti Kontraktues konsideron se situata është mjaft e qarte, dhe OE "EX-FIS SHPK", ka ofruar primiumin e larte dhe komform nenit 62 te LPP-se autoriteti kontraktues ka bere anulimin e këtij aktiviteti te prokurimit.

Me respekt,

Driton Bytyqi

Ud Drejtor i Zyres Ekzekutive te Prokurimit

Gjatë shqyrtimit te pretendimeve ankimore dhe dokumentacionit te procedures se prokurimti ofertat e operatoreve ekonomik ne procesverbalin e hapjes kan qenë si vijon:

...TENDER OPENING / ZAPISNIK OTVARAN

Numri i prokurimit Procurement number Broj nabavke:	KEK-23-6766-1-1-1	Titulli i Kontratës Contract Title Naslov ugovoru	FURNIZIM ME LËNDË DJEGËSE PËR I MAZUT(Fuel Oil 1.0%)
Numri i brendshëm Internal No Interni broj	KEKO-23-045-111		

Data e lëshimit Date of issue Datum izdavanja	Data e mbylljes Closing date Datum zatvaranja & Čas	Data e hapjes & Ora Opening date & time Datum Otvaranja & Čas	Vendi Place Mesto	Ni No Br
19.07.2023	19.07.2023, 12:00:00	19.07.2023, 12:00:00	Hapja e ofertave -KEK- Zyra Ekzekutive e Prokurimit, Toskan nr.36, 10000 Prishtinë	2

Nr. Br.	Tenderuesi Tenderer Tenderer	Kodi i tenderit Tender label /code Oznaka ponude	Pjesë Lot Lot	e-tenderit e-tender e-ponuda	Çmimi Price Cena €	Çmimi (me TVSh) Price (with VAT) Cena (sa PDV) €
1.	Ex Fis, Sheshi Bill Klinton, 10000, Prishtine	Ex Fis Mazut 23	FURNIZIM ME LËNDË DJEGËSE PËR KALDAJË – MAZUT(Fuel Oil 1.0%)	PO	4293542.92	5066380.65
2.	PATRONI SH.P.K., Miradi e Ulet, 10000, Fushe Kosove	kek 19.07.2023	FURNIZIM ME LËNDË DJEGËSE PËR KALDAJË – MAZUT(Fuel Oil 1.0%)	PO	3982252.92	4699058.45

Komisioni i hapjes / Opening commission / Komisija otvaranja

Emri Mbiemri Name Surname Ime Prezime	Nënshkrimi/ Signature/ Potpis	Datë/ Date/ Datum
BLEDAR RACAJ		

Ne bazë te LPP, Nenit 9 AK para se të publikoj dhënien e kontrates është i obliguar qe te bëj edhe njëher konfirmimin e mjeteve buxhetore përmes Deklarates se disponueshmeris se fondeve - DNPDF, edhe njëher nga ana e ZKF.- Zyrtari Kryesor Financiar

ZKA dhe ZKF konform Nenit 9 te LPP, me anë te nënshkrimit te DNPDF te dates 01.8.2023 kan konfirmuar mjetet financiare me shtesen e alokuar sipas vendimit te Bordit me shumën **499,058.45 euro(shtesë).**

Dhe nëse kalkulohët vlera e inicuar prej 4,200,000.00 euro + 499,058.45 euro shtesë, **totali i projektit to të jetë = 4,699,058.45 euro**

Andaj nëse marrim vlerën, shumën e ofertëse se operaotirt ekonomik ankues **„Patroni SHPK"** e cila është **4,699,058.45 euro** dhe vleren totale te inicuar nga AK e cila është **4,699,058.45 euro.** Oferta e operatoir ekonomik ankues **Patroni SHPK** është brenda buxhetit te planifikuar nga AK

Shih DNPDF e aprovuar nga ZPP, ZKF dhe ZKA qe dëshmon mbi posedimin e mjeteve financiare.



NENI 3: SHQYRTIMI

Deklarate e Nevojave dhe e Përcaktimit te Disponueshmerise se Mjeteve" eshtë shqyrtuar nga pe
e autorizuar për nënshkrim te kontratave para publikimit te Vendimit te autoritetit kontraktues per N
për dhënie te kontratës me qëllim qe te rikonfirmojë se informatat financiare nuk kanë ndry
materialisht.

Ndryshimet: Po ☐ Jo ☐

Nëse po, tregoni [illegible] informacionet e modifikuara

$	Vlera e ofertës 4,699,058.45 Euro
$	Mjete shtese 499,058.45 Euro

Nr. i dokumentit të Urdhëresës së Zotimit /kodi i buxhetit dhe Pagesës (UZP) *[shëno nr. UZP*
Kopja e dokumentit të UZP duhet të bashkëngjitet

Nënshkrimet:

u.d. Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit:	Emri: Ymer Dragusha	Nënshkrimi: Data: 24.07.2023
Zyrtari Kryesor Financiar:	Emri: Gramos Hashani	Nënshkrimi: Data: 24.08.2023
u.d. Zv. Kryeshef Ekzekutiv:	Emri: Perparim Kabashi	Nënshkrimi: Data: 01/08/2023

Të plotësohet Vendimit te autoritetit kontraktues para publikimit te dhënies se kontratës

Duke pasur parasysh këtë ne cilësin e ekspertit shqyrtues ne baze te provave, fakteve dhe vleres se inicuar dhe vleres se ofertës konstatoj se pretendim ankimore është **i bazuar.**

Përgjegjie e ekspertit ne pretendimin ankimore nr.2: Lidhur me prejardhje, origjinën dhe prodhuesin e Mazutit:

Në dosjen e tenderti ne Aneksin nr.1 Autorteti kontraktues ka cekur „**OE përmes nje deklarate duhet te deklarohet lidhur me vendin e origjinës se Mazutit dhe Prodhuesin„**

Kërkesa e vendosur ne Aneksin nr.1

Pika e ndezjes	°C	min. 100	min. 80	
Lagështija dhe të dhënat	%	max.2.0	max.1.5	e ngurta
Hiri	%	max. 0.20	max. 0.20	
Sulfuri i gjithmbarshëm	%	max 1	max.1	
Treguesi Conradson	%	max 10.0	max 15.0	

OE përmes nje deklarate duhet te deklarohet lidhur me vendin e origjinës se Mazutit dhe Prodhuesin.

Tenderuesi duhet të jetë në pajtueshmëri me të gjitha specifikimet e shënuara në këtë listë. Çdo kërkesë jo e përmbushur do të eliminojë tenderin për pjesën e plotë. Ju lutem kontrolloni nëse tenderi juaj plotëson secilin nga specifikimet teknike të përshkruara më lartë.

Lidhur me këto pretendime ankimore PSH.OSHP ka nxerrur vendimin **nr.2023/0563** ku si rezultat i kësaj me qëllim te vërtetimit më sakt te origjinës prodhuesit te Mazutit ka kërkuar qe procedura te kthehet ne rivleresim dhe AK te kërkoj sqarime me te duhura lidhur me origjinen e mazutit dhe prodhuesin e mazutit.

Shih paragrafin e vendimit te PSH.OSHP nr.2023/0563 lidhur me këtë rastë - prejardhjes se mazutit.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur, objektive dhe me kujdes profesional i ka administruar dhe vlerësuar të gjitha provat në shkresat e kësaj lënde dhe konsideron se AK nuk ka vepruar në harmoni të plotë me dispozitën e nenit 59 të LPP, përderisa nuk i ka përdorur apo zbatuar me kohë dhe gjatë rrjedhës së aktivitetit kompetencat e tij në vështrim të paragrafit 2, të dispozitës së cituar sipas së cilës AK mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Nga pikëpamja e Panelit dhe në kuptim të hulumtimeve të eksperti shqyrtues mund të konstatohet se, informacionet shtesë kanë qenë në fakt të nevojshme që për hire të vlerës së tenderit, rëndësisë dhe qëllimit të prokurimit të vërtetohen në mënyrë të pakontestueshme faktet përkitazi me deklaratën e prodhuesit dhe origjinën e artikullit nga ana e operatorëve ekonomik, meqë të njëjtat krijojnë ndikim qenësor në këtë aktivitet të prokurimit për arritjen e qëllimit për përmbushjen e nevojave. Dhe krahas kësaj, Paneli konsideron se në procesin e rivlerësimit, kërkohet nga AK që dokumentin e prezantuar nga OE i rekomanduar ta verifikoj ngase i njëjti përmban apo jo të dhëna dhe/ose informacione të qarta mbi prejardhjen dhe prodhuesin e mazutit, gjithnjë duke u nisur nga fakti se nuk ishte kontestuese për palët në procedurë që të dy OE pjesëmarrës në këtë aktivitet (*nënkupto:* OE i rekomanduar dhe OE Ankues) nuk kanë paraqitur një deklaratë të tillë, kurse si kriter i tillë "deklarata kontestuese" nuk ishte e vendosur në kuadër të kritereve kualifikuese por ishte është kërkuar tek aneksin 1 i DT.

Paneli në këtë rast ka konstatuar se mungesa e kësaj deklarate në raport me efektet qenësore të sajë janë konsideruar nga AK si "devijim i vogël" në kuptim të nenit 59.4 lidhur me nenet 8 dhe 9 të LPP, megjithatë sipas gjykimit të tij të pavarur e në vështrim të dispozitave të nenit 1 dhe 6 të LPP, Paneli vlerëson se në këtë rast AK është e obliguar që gjatë procesit të rivlerësimit të aplikojë nenin 52 dhe 72 të LPP për të kërkuar informata shtesë nga ana e OE-të lidhur me origjinën dhe prodhuesin e mazutit, meqë artikulli në rastin konkret e shpreh dhe përcakton qëllimin e prokurimit dhe shfrytëzimin e fondeve publike në këtë rast. Në fakt Paneli konsideron se mungesa e të dhënave të sakta përkitazi me dokumentet e cituara, si të ankuesit po ashtu dhe të operatorit ekonomik të rekomanduar, e vejnë padyshim në dilemë secilin Panel lidhur me faktin nëse vendimi i atakuar duhet mbetur në fuqi, përderisa e gjithë kjo zbrazëtirë informacionesh kanë mundur të mbulohet brenda një kohe efektive.

Në bazë te vendimit te PSH.OSHP, AK ka kthyer proceduren ne rivleresim dhe me daten 30.10.2023 me anë te Letres standarde për sqarime ka kërkuar informacione shtes lidhur me këtë nga ana eoperatoirt ekonomik.

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS Sh.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.

Letër Standarde e kërkesës për informata mbi tenderët

NGA: KEK- Zyra Ekzekutive e Prokurimit, Ndërtesa e Toskanes , Rr. Nënë Tereza, 36 1000 Prishtinë

PËR: PATRONI SH.P.K

Nr1 i prokurimit	**KEK-23-6766-1-1-1**
Nr i brendshëm	**KEKO-23-045-111**

Titulli: **FURNIZIM ME LËNDË DJEGËSE PËR KALDAJË – MAZUT(Fuel Oil 1.0%)**

I/e nderuar

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim " LPP ".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kritereve të dhëna në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.

Ne konsiderojmë që tenderi juaj është jo-normalisht i ulët në krahasim me objektin e kontratës.

Që të mund ta vlerësojmë tenderin tuaj në mënyrën e duhur, kërkojmë nga ju të jepni një shpjegim detal të elementeve përbërëse të tenderit tuaj, si në vijim:

Ne dosjen e tenderit eshte kërkuar: OE përmes nje deklarate duhet te deklarohet lidhur me vendin e origjinës se Mazutit dhe Prodhuesin.
Ju lutem te deklaroheni per vendin e origjinës se Mazutit dhe Prodhuesin.

Informatat e kërkuara duhet te pranohen **me shkrim** në platformën elektronike brenda *2* **dite** pune nga data e kësaj kërkese.

Nëse nuk marrim përgjigje nga ju mbi pyetjet e lartë shënuara brenda afatit kohor të dhënë, tenderi juaj do të refuzohet.

Ju falënderoj paraprakisht,

Me respekt,

Ymer Dragotha

(Emri dhe Mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit)

(Nënshkrimi)

30/10/2023

Operatorit ekonomik ne baze te kërkesës për sqarim derguar nga AK është përgjegjur duke derguar deklaraten si ne vijim:

PERGJIGJE PËR ORIGJINEN DHE PRODHUESIN

Patroni SHPK ju informon se origjina e Mazutit do te jetë nga Bullgaria nga prodhuesi LOTUS OIL TRADE LTD

Ne ju sigurojmë se lënda do të liferohet konform specifikave të kerkuara nga ju në dosjen e tenderit, si deshmi më e mire eshte kontrata paraprake me nr.KEK 23-8642-1-1-5/C2358 ku furnizimi është bërë konform të gjitha kërkesave të kërkuara në dosjen e tenderit dhe origjina ka qenë nga Bullgaria nga prodhuesi i njejtë.

Gjithashtu ju sqarojme se në oferten tonë kemi dorezuar një dokument me analiza të Mazutit që jemi furnizuar më herët, këtë e kemi dorezuar me qellim për të ju siguruar se ne kemi dorezuar më herët Mazut qe i plotesojne specifikat teknike të kerkuara nga ju dhe nuk ka të bëjë me Prodhues dhe Origjinen e Mazutit që do të furnizohet me këtë kontratë.

Pas analizimit te dokumenteve kërkesa juaj është përcjellë tek në konform kërkesës së vendimit nr. 2023/0563 te OSHP:

Paneli vlerëson se në këtë rast AK është e obliguar që gjatë procesit të rivlerësimit të aplikojë nenin 52 dhe 72 të LPP për të kërkuar informata shtesë nga ana e OE-të lidhur me origjinën dhe prodhuesin e mazutit, meqë artikulli në rastin konkret e shpreh dhe përcakton qëllimin e prokurimit dhe shfrytëzimin e fondeve publike në ketë rast.

Përgjigjja jonë është në përputhje edhe me vendimin e OSHP duke ju ofruar informatat lidhur me Origjinen dhe Prodhuesin.

Duke shpresuar në një vleresim të drejtë në përputhje me ligjet dhe rregulloret si dhe ruajtjes së parasë publike, në mbesim në pritje të një vendimi duke na shperblyer me këtë kontrate.

Patroni SHPK

PATRONI

Vlenë te thekësojm se ne ofertën e operatorit ekonomik është dorzuar edhe një Certifikaten e Kulitetit (Certificate of Quality) me **Nr.219/2023/RE e datës 19.07.2023**, e cila thekësohët se Vendndodhja (lokacioni) i ngarkimit është **„HELPE lonia, Thessaloniki" kurse ne te nejten certifikatë eshte e cekur edhe prodhuesi OKTA, AK ne baze te kësaj certifikate me qellim te vërtetimit te prejardhjes se prodhuesit te Mazutit ka kekruar edhe sqarimet shtes OE ne pergjegjien e tyre ka thekeseuar:**

Patroni SHPK ju informon se origjina e Mazutit do te jetë nga Bullgaria nga prodhuesi LOTUS OIL TRADE LTD

Dhe qe ne këtë rast ne certifikaten e poshtë shenuar Vendndodhja (lokacioni) i ngarkimit është **„HELPE Ionia, Thessaloniki" dhe prodhuesi OKTA**

MAKINSPECT

MAKINSPECT DOO SKOPJE
Bul. Partizanski odredi 17 A-1/1
tel: 389 2 3127 067;
e-mail: info@makinspect.com.mk

CERTIFCATE OF QUALITY

Certificate no./Certificate date. 219/2023/RE; 19.07.2023	Location of loading/inspection: HELPE Ionia, Thessaloniki	Customer/Receiver: PATRONI SH.P.K.	Date of sampling: 22.05.2023
Object (rail, car tank plates): SK-6258-AI/SK-991-TB	Date of loading/inspection: 19.07.2023	Quantity as declared by rafinery: 25.719 kg. ; 26.930 lit.	No of testing: 0483/23
Transporter: GOSV TRANS	Product: FUEL OIL.	Location of discharge: KOSOVO	No of sample/No of tank: 251/23; TK-827

PROPERTY	UNITS	RESULTS	METHODS
*Density at 15^{0} C	g/ml	0,9550	EN ISO 3675
Sulphur content	% m/m	0,892	ASTM D 4294
Viscosity at 50 ^{0} C	mm^2/s	267,0	ASTM D 445
Viscosity at 100 ^{0} C	mm^2/s	26,21	ASTM D 445
Flash Point	^{0}C	103,9	ASTM D 93
Pour point	^{0}C	-3	ASTM D 97
Water and sediments	% v/v	0,2	ASTM D 1796
Water by distillation	% v/v	0,0	ASTM D 95
Carbon residue	% m/m	10,19	EN ISO 10370
Ash	% m/m	0,034	ASTM D 482
Net heat of combustion	MJ/kg	41,13	ASTM D 4868
Gross heat of combustion	MJ/kg	43,58	ASTM D 4868

Note: This report is issued and is valid only for the sample taken by MAKINSPECT which is submitted for analisys in an accredited laboratory. The quantity stated above is according documentation issued by Greek Customs, Hellenic Petroleum and Rafinery OKTA. With this report MAKINSPECT does not guarantee the accuracy of the results of the analisys, but only that the methods used in the analisys and the obtained results are the same that are listed and received during the testimony.

*Analysis performed in Hellenic Petroleum 576; 21.05.2023
Analysis performed in OKTA REFINERY, Skopje, report number 0483/23 ;dated 26.05.2023

Approved by
MAKINSPECT LTD

МАКИНСПЕКТ

Nenin 59 i LPP sqaron mësemiri se si duhet ndjekur dhe zbatuar procedura e sqrimit te dokumneteve tenderuese.

Paragrafin 2. *Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues dhe,*

Paragrafin 4.*Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit ne fjalë.*

Duke pasur parasysh këtë ne cilësin e ekspertit shqyrtues konstatoj ankesa e operatorit ekonomik është është e pa bazuar pasi qe me kete rast pranimi i nje dokumenti me permbajtje tjetr nga ajo qe është dorzuar ne ofertë do te ishte ne kundershtim me Nenin 59 paragrafin 2 dhe 4 pikë (i) pasi qe konsiderohet i kushtit material dhe aspektit te tenderit ne fjalë , andaj bazuar ne këtë pretendimi ankimore është i **pa bazuar.**

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke pasur parasysh pretendimet ankimore dhe legjislacionin ne fuqi për prokurimin publik ne cilesin e ekspertit shqyrtues ne baze te provave dhe fakteve rekomandoj PSH.OSHP qe te aprovoj pjesërisht si te bazuar ankesën e operatorit ekonomik, dhe njëkohësisht te mbetet ne fuqi njoftimi mbi vendimin e AK lidhur me anulimin e aktivitetin ne fjalë

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **PATRONI SH.P.K.**

Lulzim Bajrami